

INFORMACION MBI AKTIVITETE SHKENCORE TË REALIZURA

A. SHKOLLA VERORE: “TEKNIKA TË GRUMBULLIMIT DHE DETERMINIT TË INSEKTEVE”

B. TRAJNIM SHKENCOR “TEKNIKA TË DETERMINIMIT TAKSONOMIK TË LEPIDOPTERA”



Prof. Dr. Anila PPARISTO

Titullar Grupi Mësimor – Kërmimor “Zoologji dhe Ekologji”

Tirana, 2022

A. Shkolla Verore: “Teknika të Grumbullimit dhe Determinimit të Insekteve”

Në kuadër të Programit Erasmus+ KA107 midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Saarland në Germani dhe Universitetit të Sofies "St. Kliment Ohridski", Bullgari u organizua një shkollë verore, përgjatë ditëve të praktikës Zoologji Invertebrore 6 – 18 Qershor 2022, me pjesëmarrjen e profesorëve **Dr. Helmut. Kallenborn, Dr. Marinela Gkrazdani** nga Universitetit Saarland dhe **Dr. Ilia Gjonov** Universitetit të Sofies "St. Kliment Ohridski", Bullgari, të ftuar pranë Departamentit të Biologjisë nga Prof. Dr. Anila Papparisto.

Ky organizim me studentët e vitit parë Biologji, por dhe me pjesëmarrjen e disa studentëve nga vite dhe degë të tjera (Kimi, etj.) të FSHN kishte si synim shkëmbimin e metodikave, teknologjisë, dhe të rejave të fundit shkencore midis stafeve akademike, ndihmës akademike dhe studentëve, përvetësimit të teknikave bashkëkohore laboratorike në funksion të rritjes së cilësisë së punës kërkimore dhe zhvillimin e metodikave të kërkimit, që pajisin studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike.

Në kuadër të këtij aktiviteti, studentët u njohën dhe me një leksion “Mëso nga Natyra”, mbi “Përdorimin e sistemeve Biologjike si bazë frymëzuese për gjetjen e zgjidhjeve inovative në çdo rrethanë”, nga Daniela Ruçi (Biologe)

Profesorët e ftuar fillimisht kryen një seancë teorike në ambientet e MSHN, duke prezantuar pjesë teorike dhe metodike dhe shpjeguar punën praktike dhe metodike që do të zhvillonin në vijim.

Në habitatet e grumbullimit, studentët u njohën nga Prof. Ilia Gjonov me teknika të determinimit në distancë të llojeve **të familjes Cicadidae (gjinkallave)** me anë të zërit që këto lloje lëshojnë. U mësua përdorimi i aparaturës, vendosja e antenës, dhe incizimi dhe regjistrimi zërit të tyre, në distancë.

Për të kryer grumbullim të insekteve në habitate bimore fushore, u praktikua teknika me thithjen e tyre me korent (elektromotor), si një pajisje e thjeshte dhe e lehtë në përdorim, por shumë efikase në grumbullim të llojeve të entomofaunës.

Gjatë praktikës ku asistoi Prof. **Helmut Kallenborn**, pas njohjes teorike të detajuar, u mësuan dhe përvetësuan teknika të grumbullimit, kryesisht të llojeve Heteroptera duke njohur habitatet e tyre, mënyrën e jetësës, grumbullimin në terren në bimësi.


Materiali i grumbulluar në teren, u konservua nga studentët, sipas metodikës së prezantuar ngë kolegët, u përcaktua në laboratin e Zoologjisë FSHN, UT, Studentët në këtë veprimtari punuan të ndarë në grupe të vogla. Ata përdorën për përcaktimin e llojeve çelsat e përcaktimit. Në fund të aktivitetit u arrit përcaktimi i materialit, etiketimi dhe vendosja e tyre në kutitë entomologjike sipas metodologjisë përkatëse.

Aktiviteti mundësoi, një pjesëmarrje aktive të të gjithë studentëve, duke krijuar hapsira në përvetësim të këtyre teknikave, dhe duke patur si rezultat përgatitjen e një koleksioni të pasur entomologjik më llojet e grumbulluar, të përcaktuar, dhe etiketuar (data, vendgrumbullimi, emri studentit, viti).

Kutitë entomologjike me llojet e konservura, do të vendosen në fondin shkencor të MSHN, pasi të qëndrojnë për 6 javë kalendarike në frigorifer në temperaturë -40°C, sipas metodikës të përcaktuar nga kolegët.

Ky fond i praktikës do të shërbejë si model për vitet në vijim, në mënyrë që të krijohet në mënyrë të vazhduar fondi i monitorimit të insektofaunës pranë MSHN.







B. Trajnimi Shkencor “Teknika të Determinimit Taksonomik të Lepidoptera”

Trajnimi shkencor “*Teknika të Determinimit Taksonomik të Lepidoptera*”, zhvillua nga kolegët Dr. **Sylvain Cuvelier** dhe Dr. **Laurian Parmentier** të Universiteti të Ghentit dhe Flemish Entomological Society të Belgjikës, përgjatë 19-20 Korrik 2022 në mjediset e laboratorit të Zoologjisë Invertenrore dhe MSHN.

Trajnimi synonte përvetësim e metodikës shkencore për përcaktim të llojeve lepidoptera, bazuar kryesisht në organet gjenitale, për të krijuar një prespektivë për përcaktime të lepidoptërëve të Shqipërisë.

Në trajnim kishte pjesëmarrës studentë nga të gjitha vitet Bachelor Biologji, Master Biologji Mjedisi, dhe ish-studentë Master Biologji Mjedisi, që ndjekin tema në fushën e studimeve të entomofaunës, ose janë të apasionuar në këtë drejtim shkencor, me qëllim krijimin e një grupi në të ardhmen për studimin e fluturave të vendin tonë.

Trajnimi zhvilloi fillimisht një paraqitje teorike dhe shumë të detajuar Identifikimin e fluturave (*Butterfly Identification*) kryesisht të Shqipërisë duke përdorur disa tregues si: Identifikimi vizual të fluturave duke u bazuar të flatrat, bimët që qëndrojnë, habitatin, kohën e fluturimit, zgjatimet e apendikseve, antenat duke u fokusuar te llojet e së njëjtës gjini, përcaktimi të cilave paraqet shpesh vështirësi për ndarjen e saktë të llojeve.

Përdorimi i barkodit gjenetik të ADN, të BIN – Barcode Index numer, për t’u përdorur në përcaktime, dhe në krijimin e fondeve shkencore dhe eksponentët e Muzeumeve Shkencore.

Informacioni teorik për përcaktimin e llojeve të gjinive (*Spialia, Pyrgus, Muschampia, Carcharodus, Erynnis* etj) të familjes Papilionidae dhe përhapja e arelit të tyre në Shqipëri.

Pjesa e dytë e trajnimit u fokusua në diseksionin e aparatit gjenital të 2 llojeve *Pieris rapae* dhe *Maniola jurtina*, të grumbulluara gjatë praktikës zoologjisë. Fillimisht studentët përgatitën 24 orë më parë materialin biologjik, duke

vendosur abdomenin e secilit lloj në shishe plastike me tretësirë Hidroksid Kaliumi KOH 10%. Më pas abdomenit me anë të gjilpërës entomologjike iu hoqën pjesët e tretura, dhe u nxorën organet gjenitale, të cilat u vëzhguan në mikroskop binokular. Studentët përgatitën pas trainimit praktik në mënyrë të pavarur disa preparate duke arritur me sukses në realizimin e tyre.

Bazuar në këtë trainim, dhe njohuritë e përfutuara, u krijua dhe një grup përfshirë , i cili do të evidentojë dhe monitorojë në kohë reale lloje të rendit lepidoptera (të grumbulluar apo vëzhguar) dhe do të kyejë përcaktimin e tyre më kohë reale.

Aktivitetet shkencore u asistuan nga stafi akademik dhe ndihmës akademik-mësimore i Departamentit të Biologjisë dhe Muzeut të Shkencave të Natyrës, Prof. Dr. Anila Paparisto, Prof. Asoc. Dr. Eltjon Halimi dhe Qazim Lataj.

